



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 200 Prot.

Tiranë, më datë 18.02.2021

VENDIM
Nr. 72, datë 19.02.2021

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 19.02.2021,

VENDOSI:

1. Miratimin e kërkesës për vazhdimin e procedurave të legalizimit për objektin “Xhamia Ebu Bekër” me vendndodhje brenda kufirit të Zonës Mbrojtëse të Qendrës Historike të qytetit të Shkodrës, deklaruar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 771, datë 30.09.2020 “Për deklarinimin pasuri kulturore të “Qendrës Historike” të Shkodrës, përcaktimin e Zonës Mbrojtëse të saj dhe miratimin e Planit për Ruajtjen, Mbrojtjen dhe Administrimin e tyre”;
2. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
3. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankimi në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Arta DOLLANI



KRYETAR
Elva MARGARITI